

# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7178  
E premte, 3 maj 2024  
Çmimi 0.50

Kuvendi mbajti seancë për Ilaz Kodrën: Ishte ndër figurat më emblematike të UÇK-së



FAQE 3

## OPOZITA PËR RAPORTIN E DASH-it: QEVERIA PO E MBRON KORRUPSIONIN

FAQE 4-5



Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të enjten seancë lidhur me publikimin e raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit për të drejtat e

njeriut, në të cilin, ndër të tjera, si problem ishte theksuar "korruptioni serioz në qeveri". Deputetët e partive opozitore e kanë kritikuar

qeverinë Kurti për mosluftim të korruptionit brenda ekzekutivit dhe për imbrojtjen e të akuzuarve për rastet korruptive

## ALI AHMETI SHPALLET "QYTETAR NDERI" I TIRANËS



## BE-ja: MASAT NDAJ KOSOVËS DO TË JENË NË FUQI DERISA TË MOS KETË ARSYE PËR TO



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: renova@m.t.net.mk

**PRINCESHA**  
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
INFO: 049-111-101, 044-511-177  
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051, 044/367-061, 028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



## AKTUALE



MACRONI PËRSËRI S'E HEDH POSHTË MUNDËSINË E DËRGIMIT TË TRUPAVE NË UKRAİNË

HAMZA TAKON AMBASADORIN E FRANCËS, DISKUTOJNË PËR SITUATËN NË MITROVICË

KDI-ja: LIGJI I (RI) I PUNËS TË RIKTHEHET NË AGJENDËN LEGJISLATIVE

BE-ja NDAN NJË MILIARD DOLLARË NDIHMË PËR LIBANIN

## EKONOMI



RRETH 100 PUNËTORË TË LËNDAR KËTË VIT, SIGURIMI SHËNDETËSOR NË SIRTAR

KOMISIONI PËR EKONOMI MIRATON PROJEKTIGJIN QË RREGULLON TREGTIMIN E KRIPTO-ASETEVE

## SPORT



LANSOHET PROGRAMI 'SUPER SPORTISTËT'

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri +38344685122  
Internet Website, Marketing...

## BE-ja ndan një miliard dollarë ndihmë për Libanin

**BRUSEL, 2 MAJ** - Shefa e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, njoftoi për një miliard dollarë ndihmë për Libanin gjatë vizitës së saj në këtë shtet që është duke kaluar nëpër një krizë ekonomike, e cila është përkushtuar nga kriza e emigrantëve dhe kërcënimi për një luftë me Izraelin. "Ju njoftoj për paketën financiare prej një miliard dollarësh për Libanin, i cili do të ndahet nga ky vit deri më 2024", tha ajo, duke shtuar se "ne dëshirojmë të kontribuojnë në stabilitetin socio-ekonomik të Libanit".

Presidentja e KE-së tha se ndihma është dizajnuar që t'i forcojë shërbimet bazike, sikurse arsimi dhe shëndetësia. Ajo i bëri thirrje

shtetit të miratojë reforma, duke theksuar se "Libani ka nevojë për një momentum pozitiv ekonomik, që do të krijonte mundësi për bizneset dhe qytetarët".

Von der Leyen tha se BE-ja është e përkushtuar që të ruajë "rrugët e hapura ligjore për në Evropë" dhe për të zhvendosur refugiatët në bllok. Por, ajo shtoi se "në të njëjtën kohë, ne llogarisim në bashkëpunimin tuaj të mirë për të parandaluar emigrimin ilegal dhe për të luftuar kontrabandën me emigrantë".

Libani përballet me një krizë të gjatë financiare. Por, shteti për pothuajse shtatë muaj po përballet me përlleshje në kufi mes grupit Hezbollah dhe Izraelit.



## Macroni përsëri s'e hedh poshtë mundësinë e dërgimit të trupave në Ukrainë



**PARIS, 2 MAJ** - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, e përsëriti të enjten se nuk e përjashton mundësinë e dërgimit të trupave në Ukrainë, duke shtuar se kjo çështje do të bëhej "legitime", nëse Rusia depërtuar përtëj vijave ukrainase të frontit dhe nëse Kievi e bën një kërkesë të tillë. Ai i bëri këto deklarata në një intervistë për "Economist", që u publikua më 2 maj.

Ekonomist tha se Macron e dha këtë intervistë, pasi e mbajti një fjalim javën e kaluar, kur deklaroi se Evropa është "e vdekshme" dhe "mund të vdesë", pjesërisht për shkak të kërcënimit që paraqet agresioni rus, pasi

Moska e nisi pushtimin e paprovokuar të Ukrainës në shkurt 2022. "Nuk e hedh poshtë asnjë mundësi, sepse ne po përballemi me dikë i cili nuk e hedh poshtë asnjë mundësi", tha Macron kur u pyet nëse ende u qëndron komenteve që i bëri në fillim të këtij viti, kur tha se nuk e përjashton mundësinë që Perëndimi të dërgojë trupa në Ukrainë.

Disa analistë besojnë se Rusia mund të jetë buzë fillimit të një ofensive të re shumë të madhe në Ukrainë.

Macroni tha se "nëse Rusia vendos të shkojë më larg, ne do të detyrohem, në çdo rast, t'ia

bëjmë vetes këtë pyetje" për dërgimin e trupave në Ukrainë. Ai e përshkroi një lëvizje të tillë si "paralajmërim strategjik për homologët e mi". Ai e përshkroi Rusinë si një "fuqi e destabilizimit rajonal" dhe si "kërcënim për sigurinë e evropianeve". "E kam një synim të qartë strategjik: Rusia nuk mund të fitojë në Ukrainë", theksoi Macron. "Nuk do të ketë siguri në Evropë, nëse Rusia fiton në Ukrainë. Kush mund të pretendojë se Rusia do të ndalet aty? Çfarë sigurie do të ketë përvendet e tjera fqinje, Moldavinë, Rumaninë, Poloni, Lituaninë dhe të tjerët?" pyeti ai.

## Irani sanksionon kompani dhe individë amerikanë dhe britanikë

**TEHRAN, 2 MAJ** - Teherani ka vendosur sanksione kundër një grupi kompanish dhe individësh amerikanë dhe britanikë, përfshirë kundër ministrit britanik të Mbrojtjes, Grant Shapps, shkaku i mbështetjes së tyre për Izraelin në luftën e tij në Rripin e Gazës.

Në një komunikatë përmes medias më 2 maj, Ministria e Jashtme e Iranit tha se kompanitë dhe zyrtarët britanikë u sanksionuan për shkak se Britania e Madhe e "mbështet qëllimshëm" Izraelin, përfshirë "kryerjen e veprave terroriste" të cilat e kërcenojnë paqen rajonale.

Cak i sanksioneve janë gjithashtu edhe disa zyrtarë ushtarake, përfshirë Simon Croke, komandanti i Forcës Ajrore Mbretërore, Akrotiri, një bazë ajrore britanike në Qipro që përdoret nga avionët luftarakë RAF për t'i sulmuar rebelët e lidhur me Iranin, Huthi, në Jemen. Irani vendosi sanksioneve edhe

kundër prodhuesit të armëve me bazë në ShBA dhe anëtarëve të lartë të grupeve hulumtuese, për shkak të mbështetjes së Izraelit. Lockheed Martin, General Dynamics dhe kompania e energjisë Chevron u sanksionuan. Në mesin e individëve të sanksionuar nga Irani është Brad Cooper, i cili është i identifikuar si komandant i Flotës së Pestë të Marinës së Shteteve të Bashkuara në Lindjen e Mesme. Cooper ia dorëzoit komandën e Flotës së Pestë George Wikoffit më 1 shkurt. Të sanksionuarve do t'i ngrihen llogaritë bankare në Iran dhe atyre nuk do t'u lëshohen viza për t'u futur në territorin iranian.

Derisa ndikimi i këtyre sanksioneve imbetet i paqartë, ato duket të jetë shumë simbolike. Avionët luftarakë amerikanë dhe britanikë i sulmuan pozicionet e grupit Huthi disa herë në fillim të këtij viti, si përgjigje ndaj sulmeve të rebelëve jemanas kundër anijeve tregtare në Detin e Kuq.



Huthi është zotuar se do t'i vazhdojë sulmet, nëse nuk arrihet marrëveshje përmëpushim në Gazë.

Izraeli e nisi luftën në Gazë në tetor 2023, si hakmarrje ndaj një

sulmi befasues në vendbanimet izraelite nga Hamasi - grupi i shpallur organizatë terroristë nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Gati 1 200 njerëz, kryesisht civilë, u vranë gjatë sulmit të udhëhequr nga Hamasi.

Ministria e Shëndetësisë në Gazën e udhëhequr nga Hamasi thotë se më shumë se 34 000 njerëz janë vranë në luftën e Izraelit.

# Kuvendi mbajti seancë për Ilaz Kodrën: Ishte ndër figurat më emblematike të UÇK-së

Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancë solemne në nderim dhe përkujtim të dëshmorit dhe komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ilaz Kodrës dhe 315 dëshmorëve e martirëve të rënë për lirinë e Kosovës më 30 prill 1999 në Drenicë. Me këtë rast janë mbajtur fjalime nga udhëheqësit e shtetit dhe deputetët që janë paraqitur në emër të partive parlamentare, të cilët e kanë lartësuar sakrificën e Ilaz Kodrës.



EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 2 MAJ** - Të enjten Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancë solemne për nder të rënies heroike të komandantit Ilaz Kodrës dhe të 315 dëshmorëve e martirëve të tjerë të rënë më 30 prill 1999 në fshatrat e Drenicës. Kryetari i komunës, Fadil Nura, nënëkryetari gjeneral Sami Lushtaku, së bashku me drejtoret komunalë, si dhe familja e Ilaz Kodrës, kanë marrë pjesë si të ftuar në këtë seancë. Me këtë rast janë mbajtur fjalime nga udhëheqësit e shtetit dhe deputetët që janë paraqitur në

emër të partive parlamentare, të cilët e kanë lartësuar sakrificën e Ilaz Kodrës, gjaku i të cilit, por edhe i dëshmorëve dhe martirëve të tjerë, sollën lirinë dhe më vonë pavarësinë e vendit. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, theksoi se sulmet e regjimit gjenocidal të Serbisë mbi fshatrat e Drenicës kishin për qëllim shfarosjen e popullit shqiptar. "Përballë regjimit kriminal të Serbisë, Ilaz Kodra me bashkëluftëtarët qëndruan të vendosur për të luftuar për idealët e lirisë, drejtësisë dhe dinjitetit shtetëror. Heroi Ilaz Kodra ndoqi idealin e komandantit Adem Jashari, duke e konsideruar lirinë



si të panegociueshme dhe sublime të popullit të tij ndaj edhe u përfjetësua. Ilaz Kodra, ashtu siç e nisi aktivitetin e tij patriotik, edhe përfundoi duke mbrojtur dinjitetin dhe identitetin tonë kombëtar. Kauza e tij ishte liria, andaj ai ra për liri dhe shtet. Ilazi nuk u kthye ne shtëpinë e tij, por Kosova e lirë dhe e pavarur mbeti shtëpia e tij e përfjetësme. Heronjtë janë më shumë se sa shtatore në bronze. Ata janë kujtesa jonë e përhershme. Janë themeli mbi të cilin eshtë krijuar shteti ynë", ka thënë Osmani. Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se heroi Ilaz Kodra eshtë ndër figurat më emblematike të UÇK-së, e cila i përket bërtamës themeluese të kësaj ushtri të lavdishme në krye me komandantin legjendar Adem Jashari. "I rritur e frymëzuar në frymë patriotike, Ilaz Kodra nuk kishte asnjë iluzion që Kosova mund të çlirohet pa luftë, për këtë arsyesh bashku me Adem Jasharin, Hamëz Jasharin, Zahir Pajazitin e të tjerë në njësitet e parë ushtarët që ishte bërtama e UÇK-së. Ky

grup patriotësh e panë të parët lirinë e Kosovës, prandaj sakrifikuani çdo gjë që këtë liri ta shohë e ta gjëzojë i gjithë populli ynë", ka thënë Konjufca. Ndërkëq kryeministri Albin Kurti ka thënë se seancat e veçanta sikur kjo, jashtë punës dhe ecurisë së rregullt të Kuvendit të Kosovës, e freskojnë fryshtë që e ka krijuar Republikën tonë, e që janë dëshmorët e kombit dhe martirët e lirisë së Kosovës. "Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, sot më 2 maj 2024 jemi mbledhur në Kuvendin e Kosovës që nga ky vend t'i përkujtojmë dhe nderojmë 315 dëshmorë dhe martirët e rënë për lirinë e Kosovës para 25 vitesh, më 30 prill të vitit 1999, në Drenicë. Për ta kujtuar luftëtarin e paepur të lirisë, Ilaz Kodrën, bashkëluftëtarin e Adem Jasharit dhe një nga të parët e grupeve të armatosura që i hodhën themel mbi të cilat u ngrit Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Po e kujtojmë sot, një ditë para ditelindjes së tij, kur ai do të bëhej 58 vjeç, meqë Ilaz Kodra kishte

lindur më 3 maj 1966 në Prekaz. Ilaz Kodra u aktivizua politikisht qysh gjatë rinisë së tij të hershme, duke marrë pjesë në demonstratat popullore më 1981, 1988, 1989 dhe 1990, kundër shtypjes politike dhe diskriminimit të shqiptarëve nga pushteti i Serbisë nën Jugosllavi", ka thënë Kurti.

Ai ka shtuar se në nëntor të vitit 1991 Ilaz Kodra së bashku me Fadil Kodrën, Adem Jasharin, Murat Jasharin dhe Sahit Jasharin iu bashkuai grupit të dytë të vullnetarëve që u stërvitën ushtarakisht në Shqipëri nga oficerët e armatës shqiptare. "Atëkohë Ilazi ishte 25 vjeç. Pas kthimit të tyre në Prekaz, kur policia e Serbisë kreu sulmin e parë ndaj familjes së Shaban Jasharit në Prekaz, më 30 dhjetor 1991, Ilazi ishte ndër ata që bashkë me shokë rezistuan me armë atë ditë. Veçanërisht pas asaj kohe, oda e familjes Kodra u bë një nga bazat e hershme të grupeve të armatosura që e rritën dhe e ngritën Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës", ka thënë Kurti.

## BE-ja: Masat ndaj Kosovës do të jenë në fuqi derisa të mos ketë arsyet për to



**PRISHTINË, 2 MAJ** - Zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, tha se për heqjen e masave ndëshkuese që blloku ka vendosur ndaj Kosovës, vendosin shtetet anëtare e jo Qeveria e Kosovës.

Stano më 2 maj tha se mbajtja e votimeve në komunat në veri të Kosovës më 21 prill ishte një prej disa kushteve që BE-ja vendosi për heqjen e masave ndaj Kosovës. Këto votime, ku qytetarët mund të zgjidhnin nëse dëshironin ose jo t'i largonin kryetarët shqiptarë të zgjedhur vitin e kaluar, dështuan për shkak të pjesëmarrjes së pamjafueshme në votime.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të enjten se qeveria që ai udhëheq ka përmbrushur të

gjitha kërkesat e BE-së për heqjen e masave kufizuese. "Kur i kemi vendosur masat kemi thënë se ato janë të përkohshme dhe mund të hiqen. Por, për këtë vendosin vendet anëtare të BE-së e jo Qeveria e Kosovës. Masat nuk ishin vendosur vetëm për një arsyesh, por për disa. Diskutimet për këtë janë në vazhdim e sipër më BE dhe vendet anëtare do të vendosin se a do të hiqen masat dhe kur, a do të hiqen të gjitha apo pjesërisht", tha Stano.

Sipas Stanos, vendimi për heqjen e mundshme të masave ndaj Kosovës kërkon një konsensus më të gjërë në gjithë BE-në. "Ka masa që janë vendosur ndaj Kosovës për arsyesh specifike. Kur shtetet anëtare vendosin ta bëjnë këtë dhe arsyet nuk ekzistojnë më, ato

do të vendosin t'i heqin masat përsëri, gradualisht ose tërësisht. Por, nuk lidhet vetëm me një incident apo një ngjarje", tha ai. Komisioni Evropian kishte vendosur masa ndëshkuese ndaj Kosovës një vit më parë për shkak të përkallëzimit të situatës së sigurisë në veri të shtetit.

Kosovë, të cilat ishin paraparë të dorëzoheshin përmes Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor dhe IPA 2024 (Instrumentet e Para-Anëtarësimit).

Pas masave ndëshkuese, Kosova mbeti jashtë granteve që BE-ja miratoi në korrik të vitit të kaluar në vlerë prej 2.1 miliardë eurosh. Në fund të prillit, disa burime diplomatike në BE i thanë "Radios Evropa e Lirë" se shumica e shteteve dërguese të bllokut janë në favor të heqjes të të gjitha masave ndaj Kosovës, ndërsa një numër më i vogël i shteteve do që hecja e tyre të bëhet në mënyrë graduale. Kundër heqjes së masave, sipas këtyre burimeve, nuk eshtë shprehur asnjë vend anëtar i BE-së.



# Opozita për raportin e DASH-it: Qeveria po e mbron korrupsionin

Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të enjten seancë lidhur me publikimin e raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit për të drejtat e njeriut, në të cilin, ndër të tjera, si problem ishte theksuar "korrupsioni serioz në qeveri". Deputetët e partive opozitare e kanë kritikuar qeverinë Kurti për mosluftim të korrupsionit brenda ekzekutivit dhe për mbrojtjen e të akuzuarve për rastet korruptive

**PRISHTINË, 2 MAJ** - Deputetët e partive opozitare në Kuvendin e Kosovës e kanë kritikuar qeverinë e udhëhequr nga Albin Kurti për mosluftim të korrupsionit brenda ekzekutivit dhe, siç kanë thënë, për mbrojtjen e të akuzuarve për rastet korruptive.

Seanca është mbajtur lidhur me publikimin e raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit për të drejtat e njeriut, në të cilin, ndër të tjera, si problem ishte theksuar "korrupsioni serioz në qeveri".

Shefi i grupit parlamentar i subjektit më të madh opozitar, Partia Demokratike e Kosovës, Abelard Tahiri, gjatë seancës së jashtëzakonshme tē enjten, që u thirr për të diskutuar për këtë raport, tha se gjetjet e raportit janë edhe një arsy me shumë që vendi të shkojë në zgjedhje sa më shpejt. "Kërkojmë që t'i trajtojmë gjetjet dhe t'i japim rekomandime kësaj qeverie për t'i adresuar deri në kohën kur vendi do t'u drejtohet kutive tē votimit dhe vendi do ta krijojë një qeveri e cila do tē jetë shpresë për qytetarët", ka thënë ai. Sipas tij, Kosova me ekzekutivin aktual nuk mund tē anëtarësohet as në organizata ndërkombëtare, në kohën kur, sipas tij, ministrja e

Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, përballet me akuzë për mosdeklarim të pasurisë.

Në raportin e fundit të DASH-it për të drejtat e njeriut në botë për vitin 2023, që u publikua javën e kaluar, thuhet se në Kosovë ka pasur "disa raportime për korrupsion në qeveri" dhe se "zyrtarët, nganjëherë, përfshihen në praktika korruptive pa u ndëshkuar".

Mimoza Kusari-Lila, shefe e grupit parlamentar të partisë në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje (LV), tha se raporti është krejtësisht normal dhe nuk ka "asgjë të jashtëzakonshme" në të. Duke folur për korrupsionin në qeveri, Kusari-Lila tha se raporti i DASH-it është bazuar në hetime penale, pra nuk flitet për aktakuza sepse nuk ka të tillë, as për procese gjyqësore as dënimë për korrupsion, vetëm për kallëzime. Këto kallëzime mund tē bëhen nga individë, opozita apo trupa të kontrolluar prej tyre", ka thënë ajo.

Armend Zemaj, nga subjekti opozitar Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), tha se raporti i publikuar më 22 prill ka

konfirmuar edhe njëherë mendimin e partisë së tij se qeveria Kurti nuk e lufton korrupsionin. "Raporti rrënoi përtokë propagandën e shumicës se e kemi luftuar korrupsionin. Në fakt ju po i luftoni ata që e luftojnë korrupsionin. Tani që kemi raportin, i cili ka konfirmuar secilin shqetësim si LDK, tani me vulën e ShBA-së jeni hajna të certifikuar, sepse qeveria juaj po emërtohet korrupsion serioz qeveritar", ka thënë ai.

Besnik Tahiri, shef i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), ka theksuar se qeveria Kurti është "rrethuar me terrin e arbitraritetit dhe arrogancës". "Në të gjitha aferat që lidhen me keqmenaxhimin e parasë publike, aferat korruptive që janë publike, ka pasur mbrojtje në formë të një luftëtarit - në mbrojtje të një të zeze", ka thënë ai.

Në seancën e Kuvendit të Kosovës, ministri i Financave, Hekurin Murati, ka bërë një krahasi se sa herë është përmendor fjalë korrupsionin në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH) në vitin 2023 dhe sa herë në vitin 2019. Nëse mbështetimi në aspektin kuantitativ atëherë, sipas tij, i bie që ka përgjysmim të korrupsionit në vend. "Nëse duhet t'i qasemi kësaj çështjeje në mënyrë kuantitative dhe objektive, në vitin 2023 fjala korrupsion në raportin e DASH-it përmendet 12 herë, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 24 herë e përmendur. Sipas raportit të DASH-it, nëse e shikojmë në suaza kuantitative, ka përgjysmim së paku", u shpreh ai.

Murati e ka akuzuar opozitën se në të kaluarën ligjet u kanë shërbuer oligarkëve e grupeve të interesit. "Në Kuvend ka ndërruar situata. Shumica e ligjeve që mbështeten nga qeveria dhe nga grupei parlamentar i LV-së janë ligje të mira, në të mirë të qytetarëve. Nuk ka monopole qysh keni bërë ju, duke u shërbuer oligarkëve e grupeve të interesit", ka thënë Murati. Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit për të drejtat

e njeriut për vitin 2023 ka konstatuar se Kosova vazhdon të përballet me probleme serioze në pavarësinë e gjyqësorit, kufizime serioze në lirinë e shprehjes dhe të medieve, përfshirë kërcënime apo dhunë kundër gazetarëve, dhe me problemin e dhunës me bazë gjinore.

Në raportin e DASH-it u përmend se më 2023 nuk ishte raportuar për ndonjë ndryshim të madh sa i përket situatës me të drejta të njeriut në Kosovë.

## Tensione në Kuvend mes deputetëve të PDK-së dhe LV-së, Bogujevcit thérret sigurimin

Një situatë e tensionuar është krijuar në këtë seancë. Nënkyetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevcit, ka kërkuar nga sigurimi ta largojë nga salla deputetin e Partisë Demokratike të Kosovës, Ferat Shala dhe atë të Lëvizjes Vetëvendosje, Salih Zyba. Ky i fundit ka vepruar kështu për t'i dalë në "mbrojtje" koleges së tij. Nënkyetarja Bogujevcit vazhdimesht u ka bërë thirrje dy deputetëve që t'ë ulen në vendet e tyre, mirëpo më pas e ka thirrur sigurimin i largojë nga salla. "Mos më detyroni ta thërras sigurimin. Sigurimi, (futuni) tani në sallë dhe largoni të dy deputetët që i përmenda me emëri. E kam të pamundshme që në seancë burrat ngritën në këmbë dhe më tregojnë sesi ta bëj interpretimin e Rregullores. Mjaft më!", ka thënë Bogujevcit. Pasi sigurimi nuk hyri në sallë, Bogujevcit tha se Shala dhe Zyba nuk do tē kenë më të drejtën e fjalsës.

# Ali Ahmeti shpallet “Qytetar Nderi” i Tiranës

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**TIRANË, 2 MAJ** - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrin, Ali Ahmeti, është shpallur “Qytetar Nderi” i Tiranës. Të pranishëm në ceremoni ishin edhe kryeministri Edi Rama, kryetarja e Kuvendit, Lindita Nikolla, ish-presidentët Moisiu dhe Topi si dhe shumë personalitete të tjera.

Kryeministri Rama ka thënë se Ali Ahmeti është një shqiptar ndër më të mirë, i cili vite më parë iu ngjit maleve të rezistencës përliri dhe të drejta të barabartë të vëllezërve dhe motrave në Maqedoni. “Me armët luftarake dhe asaj rezistence nuk kërkoi as gjakderdhje, as hedhjen në erë të shtetit të pavarësuar nga shpërbërja e Jugosllavisë. Armët në krahun e asaj rezistence malesh nuk synon ndarjen e Maqedonisë, por bashkimin e saj nën të njëjtin flamur vlerash dhe parimesh mes vlerave demokratike të dy popujve. Rruja e rezistencës së maleve që Ali Ahmeti e hapi me armët në

krah, ishte rruga e një vizioni patriotik paqeje. Ato armë në krah nuk ishin as një blof politikanësh të verbuar nga etja përpushtet dhe as një shaka aventurierësh. Është ende herët përt'u shkruar historia e kësisoj shqiptari ndër më të mirët, por nuk është herët të thuhet se ndër shqiptaret e kësaj kohe, ndër të cilat shkëlqen edhe ndryshimi rrënjesor i shqiptarëve në Maqedoni, Ali Ahmeti është mjeshtri më i madh i përdorimit të armës së demokracisë përt a affirmuar subjektivitetin tonë kombëtar. Pa Ali Ahmetin shqiptarët e Maqedonisë nuk do të ishin sot në ditën më të mirë”, ka thënë Rama.

Ndërsa kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, ka thënë se është ndër i veçantë që një mik, frysëzues dhe misionar si Ali Ahmeti, ndodhet sot në kryeqytetin shqiptar dhe i bashkohet Tiranës si qytetari më i ri. “Është ndër i veçantë që sot, miku, vëllai, frysëzuesi, misionari, kryetari Ali Ahmeti dhe familja e tij e bukur na është bashkuar, teksha do të jetë qytetari më i ri i Tiranës sonë të madhe. Tirana, sic e përmendim

ne në zhargonin tonë, i ka me pikatore qytetarët e nderit. Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Kristo Frashëri, Adem Demaçi, përt përmendur disa dhe sot do t'i bashkohet këtij gjerdani të njerëzve që e nderojnë qytetin tonë, me qytetarinë e nderit, kryetari ynë, lider, misionar, frysëzues, Ali Ahmeti”, ka thënë Veliaj.

E Ali Ahmeti gjatë fjalës së tij tha se Shqipëria, ndonëse e varfér, ka treguar gjithmonë zemrën e ngrëjtë përt shqiptarët kudo që jetojnë. “Do doja t'ju falënderoj nga zemra. Kjo është Tirana edhe e Adem Jasharit. Kjo është Tirana e Zahir Pajazitit, po edhe e Fehmi Lladrovcit dhe Xhevë Krasniqit. Kjo është Tirana që akoma buzëqeshë kur ka parë kompaninë e parë që po futet në Kosovë, Luan Haradinajn, që si djalin e vet e ka mbajtur nëna Dritë. Kjo nënë Tirana, Shqipëria, ka qenë e varfér, por na ka mbajtur ngrëjtë në gjirin e saj. Me qindra janë dëshmorë, hero të kombit që i ka mbajtur nëna në prehrin e vet. Unë do të doja t'ju falënderoj, por një fjalë e një plaku të urtë na tha: mos e falënderoni njëri-tjetrin, sepse

të gjithë keni punuar në arën tuaj, vetëm punë e mbarë përt të gjitha punët kur bëhen”, ka thënë Ahmeti.

Ai ka theksuar se Shqipëria ka ndarë bukë, krip e zemër përt ne. “Përt të gjithë ata që sot nuk janë, sot është Kosova shtet, sot shqiptarët janë shtetformues në RMV. E kam thënë botërisht kur e kemi nisur, e kam thënë ka qenë përt bashkimin e trojeve shqiptare, e kemi nisë të tillë, por rrethanat ndryshuan, por edhe ne ndryshuan strategjinë, duke parë gjeopolitikat, gjeostrategjitet dhe u përkushtuan përt çlirimin e Kosovës, por pa garancitë se nuk do të ketë kryengritje në Maqedoni sepse shqiptarët që morën pjesë vullnetarisht, ca u vrancë në burgjet e Idrizovës, dhe kjo situatë ishte e papërpunueshme shumë më herët, sepse shqiptarët ishin në RMV të shkelur, marginalizuar, pa të drejta, pa flamur, pa simbole”, ka thënë lideri i BDI-së, ku më pas iu drejtua në emër kryeministrin Edi Rama. “I dashur Edi, sot edhe ju Skënderbeun e keni në Tiranë, po edhe unë e kam në Shkupin e vjetër, mu në qendër. Edhe ju me krenari e mbani flamurin kombëtar, po edhe ne dënohemë nuk e respektojmë flamurin shqiptar. 5 mijë euro është gjoba nëse nuk e kemi. Kemi tre universitete. I dashur Edi, ia kemi marrë kazerma Mlladiqit. Në Shkup është universiteti. Në Kumanovë përsëri kazerma e Mlladiqit është Universitet i Tetovës. Kemi dhe shumë punë përt të bërë dhe unë do të doja të falënderoj nga zemra përt përkrahjen që na ka dhënë shteti shqiptar. Tirana, unë e njoh Tiranën e '91-shtet dhe sot nuk e njoh Tiranën e 2024-s. Humbëm dhe nuk e di ku jam. Një Tiranë tjetër krejtësisht dhe kjo më gjëzon mua dhe çdo shqiptar që e viziton. Unë do të doja t'ju falënderoj shumë përt këtë ndër, e ndaj me 3 mijë mbetje mortore që i kam në vendlindje se përt këtë flamur dhe këtë gjuhë janë vrarë dhe ju më keni nderuar mua. Ju falënderoj shumë! Suksese paç në të gjitha fushëveprimtaritë e jetës”, ka thënë Ali Ahmeti. Lideri i BDI-së para disa ditësh është shpallur edhe “Qytetar Nderi” i Prizrenit.

## Hamza takon ambasadorin e Francës, diskutojnë për situatën në Mitrovicë

**MITROVICË, 2 MAJ** - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur ambasadorin francez në Kosovë, Olivier Guerot. Në takim, Hamza e ka informuar

ambasadorin Guerot për situatën aktuale në komunë dhe për projektet që janë duke u realizuar për të mirën e qytetarëve të Mitrovicës. Kryetari Hamza shprehu

falënderim ndaj ambasadorit Guerot për përkrahjen që Franca ka dhënë për Kosovën në procesin e zhvillimit dhe shtetndërtimit të saj. Gjithashtu, ata konfirmuan

përkushtimin dhe gatishmërinë për ta thelluar më tej bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve në fusha të interesit të përbashkët.



## Osmani dhe Kurti bëjnë homazhe në përvjetorin e masakrës së Studimes



**VUSHTRRI, 2 MAJ** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti, kanë bërë homazhe dhe kanë marrë pjesë në akademinë përkujtimore në përvjetorin e masakrës së Studimes së Vushtrrisë.

Në fjalën mbajtur para të pranishmëve, presidentja Osmani ka theksuar se "fjalët nuk mund ta shprehin në mënyrë të duhur pikëllimin që ndiejmë për 116 jetët e humbura të banorëve të Studimes nga ky akt barbar i forcave të regjimit gjenocidal të Serbisë". "Megjithëse plagët e luftës dhe të ditës së kobshme në Studime mund të mos shërohen kurrë plotësisht, shpirti i

banorëve mbetet i pathyer. Studimja tashmë është ringritur, teksa banorët, krahas me shpresën për drejtësi, shikojnë kah e ardhmja. Do t'i kujtojmë martirët përherë për të mos u harruar, sikurse do t'i kujtojmë të gjitha masakrat nëpër Kosovë!", ka thënë Osmani.

Para të pranishmëve kryeministri tha se padrejtësinë për viktimat shqiptare, përfundimisht dërgohet dot mes shteteve dhe kombeve që ndërtojnë të ardhmen e tyre mbi vlerat njerëzore. "Masa e krimit e detyroi edhe NATO-n atëbötë të ndërhynte. Nuk mund të mos jepet drejtësia për një masë te tillë krimi", u shpreh ai.

## ShSKUK-ja bëhet me dy klinika, kostoja mbi 4 milionë euro

**PRISHTINË, 2 MAJ** - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia dhe drejtori i ShSKUK-së, Elvir Azizi, kanë vendosur të enjten gurthemelin për ndërtimin e Hematonkologjisë dhe atë të Nefrologjisë. Kostoja e ndërtimit të këtyre klinikave është rreth 4.3 milionë euro, ndërsa afati përfundim është 36 muaj. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, tha se me ndërtimin e

këtyre klinikave do të plotësohen standartet moderne. Si pasojë e gjendjes në klinikat aktuale, Vitia tha se nuk kanë mundur të jepen shërbime. "Jam shumë i gëzuar që gjendem sot në ambientet e QKUK-së ku bashkë me dy profesorët e nderuar, Emrushin dhe Shemin dhe drejtorin e ShSKUK-së, hodhëm gurthemelin për klinikën e re të

Hematonkologjisë dhe të Nefrologjisë, që do t'i plotësojnë standartet moderne të cilat tani për shkaqe të infrastrukturës së vjetër dhe të dëmtuar, klinikat aktuale, përkundër angazhimit dhe përkushtimit maksimal të profesionistëve shëndetësorë, nuk kanë mundur të jepin shërbime. Përfundimi i kësaj klinike kap vlerën diku 4.3 milionë euro", u shpreh Vitia.



## Vlora Humollı-Jashanica emërohet drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport



**PODujevë, 2 MAJ** - Me vendim të kryetarit të komunës, Shpejtum Bulliqi, Vlora Humollı-Jashanica është emëruar drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport. Vlora ka përfunduar studimet universitare të Kulturës Fizike dhe masterin Kulturë Fizike, Sport dhe Rekreacion. Ka punuar nga viti 2006 mësimdhënëse në shkollën

"Zenel Hajdini" në Lupç të Poshtëm, krahas kësaj ka punuar mësimdhënëse e Kulturës Fizike për disa vjet në shkollën "Zenit", Qendrën Sociale-Edukative "Don Bosko", shkollën "Princeton" si dhe trajnere e gjimnastikës. Vlora vjen nga një familje patriotike që ka kontribuar shumë për lirinë e Kosovës. Ajo është

motra e Elfete dhe Mentor Humollit, dy dëshmorëve të Kosovës. Kryetari Bulliqi e ka uruar Vlora Humollı-Jashanicën për detyrën e re, duke i dëshiruar sukseset dhe mbarësi në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive, si dhe i ka siguruar mbështetje dhe bashkëpunim të plotë.

## Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi me organizatën "Toka"

**KAMENICË, 2 MAJ** - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, së bashku me drejtoreshën ekzekutive të organizatës "Toka", Jehona Gurgejala, kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit e cila ka për qëllim zhvillimin e projekteve që do të realizohen për

fuzizimin e rinisë. Iniciativa "Komunat për Rini" ka për qëllim thellimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet "Toka"-s dhe komunave të Kosovës për periudhën 2024-2025. Përmes kësaj nisme, "Toka" dhe komuna e Kamenicës do të kenë mundësi të

bashkëpunojnë në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar në fushën e edukimit dhe të rinisë. Marrëveshja në parim si objektivë ka zhvillimin dhe zbatimin e programeve për ta stimuluar aktivizmin qytetar, aftësimin dhe fuqizimin e rinisë së Kamenicës.



# KDI-ja: Ligji i (ri) i Punës të rikthehet në agjendën legjislative

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 2 MAJ** - Institutit Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar të enjen analizën "Ligji i ri i Punës: në mes të nevojës dhe kërkesave për ndryshim".

Duke iu referuar përpjekjeve të pasuksesshme të disa qeverive tash e disa vjet për ta avancuar marrëdhënien e punës në Kosovë, përmes këtij punimi diskutues KDI po synon ta rikthejë në diskursin publik debatin për iniciimin e një ligji të ri të punës, i cili e ka bazën në nevojat dhe kërkesat e punëtorëve, organizatave sindikale e OJQ-ve, në përpunës me standardet dhe praktikat e vendeve të Bashkimit Evropian, e që garanton mbrojtje më të mirë për punonjësit në Kosovë.

Ligji aktual i Punës paraqet një ndërligjet më vitale në vend duke qenë se rregullon punësimin e mbi 370 000 punonjësve në sektorin publik e atë privat. Ndryshimi i këtij ligji ka qenë premtim i çdo qeverie që nga viti 2012, ndërkohë që drafte të ndryshme kanë arritur të bëhen edhe pjesë e agjendave legjislative. Sidoqoftë, këtë vit, qeveria aktuale ka vendosur ta tërheqë këtë ligj nga agjenda legjislative pa ndonjë

paralajmërim, përkundër që trendi i shkeljeve të të drejtave të punës vazhdon të jetë në rritje.

Albesa Humolli nga KDI-ja ka deklaruar se ligji aktual i punës nuk ofron mbrojtje dhe siguri të mjaftueshme për punonjësit, duke i lënë ata të ceneseshëm ndaj shfrytëzimit, diskriminimit dhe kushteve të pasigurta të punës. "Kohëzgjatja" dhe mungesa e kufizimeve sa iu përket kontratave për kohë të pacaktuar, rregullimi i pushimit të lehonisë, mungesa e pushimit prindëror, mungesa e kufizimeve sa iu përket orëve shtesë të punës, mungesa e kufizimeve sa i përket formalizimit të marrëdhënies së punës, çështja e rregullimit të punës me orar jo të plotë, çështja e së drejtës në pushim për punonjësit apo çështjet e tjera si rregullimi i punësimit në kohët moderne si puna hibride, puna nga shtëpia, apo puna për kompani jashtë vendit konsiderohen të jenë disa nga mangësitë e ligjit aktual të cilat asnjëherë nuk kanë arritur të adresohen", ka thënë ajo.

Humolli thekson se mangësitë e një ligji 'të stërvjetruar' të punës po bien në kurrizin e punonjësve në Kosovë, të cilët ende përballen me informalitet në punësim, mungesë të kushteve për punë, mospagesë të pushimit vjetor apo mjekësor, pagë jo të rregullt



apo orar të tejzgatur pune pa pagesë. Për më tepër, edhe institucionet ligjzbatuese, me gjithë përpjekjet e tyre, nuk po arrinë ta mbikëqyrin zbatimin e ligjit në masë të duhur.

Sipas Humollit, ndryshimi i ligjit aktual ose iniciimi i një ligji të ri të

punës është i nevojshëm marrë parasysh aspiratët e vendit përiu bashkuar tregut evropian të punës, që nënkupton se ligji duhet të përafrohet me kërkesat që dalin nga 17 direktivat e Bashkimit Evropian që përcaktojnë standardet

minimale në fushën e rregullimit të marrëdhënies së punës.

KDI-ja kërkon nga qeveria të reflektojë në këtë drejtim dhe ta fillojë dialogun social më të gjitha palët në mënyrë që ligji i punës të rikthehet në programin legjislativ për këtë vit.

## Gërvalla takoi ministrin e Jashtëm të Estonisë, biseduan për marrëdhëni bilaterale



**PRISHTINË, 2 MAJ** - Bashkëpunimi në mes të Republikës së Kosovës dhe Estonisë në fushën e digitalizimit, e-qeverisjes, shërbimeve online, shkëmbimin e përvojave dhe fuqizimin e marrëdhënieve në fushat me interes të përbashkët, ishin temat kryesore të takimit që zëvendëskryeministria dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, pati me ministrin e Punëve të Jashtme të Estonisë, Margus Tsahkna, në margjina të takimit të ministrave të BE-së me ministrat e shteteve që kanë një perspektivë të anëtarësimit në BE, pra të Ballkanit Perëndimor, Turqisë, Ukrainës, Gjeorgjisë dhe Moldavisë.

Dy ministrat biseduan rrëth situatës së sigurisë në Evropë dhe Ballkanin Perëndimor, rreziqeve që kërcënohen nga Rusia dhe satelitët e saj si Serbia si dhe nevojën e ndërmarrjes së

veprimeve të përbashkëta përuajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon dhe me gjérë.

Gjatë këtij takimi ministrja Gërvalla e njoftoi ministrin e Punëve të Jashtme të Estonisë, Margus Tsahkna, rrëth përparimit që Republika e Kosovës ka shënuar në shumë fusha, përfshirë sundimin e ligjit, demokratizimin e vendit dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, fusha këto të cilat janë konfirmuar nga raporte të ndryshme ndërkombëtare, por edhe nga rapporti i raportueses për Kosovën në Këshillin e Evropës, Dora Bakoyannis.

Më tej ministrja Gërvalla e falënderoi homologun estonez për mbështetjen e madhe që Estonia i ka dhënë Kosovës në procesin e anëtarësimit në Këshillin e Evropës dhe tani në hapin e fundit për anëtarësim në Këshillin e Ministrave.

### Mentor Latifi, ambasadori i ri Kosovës në Zvicër

**PRISHTINË, 2 MAJ** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka emëruar të premten Mentor Latifi, ambasador të Kosovës në Zvicër. Lajmin

e ka dhënë Osmani në rrjetin social "X". "Ambasadorit të emëruar Mentor Latifi i urova suksesë në detyrën e tij ambasador i ri i

Republikës së Kosovës në Konfederatën Zvicerane. Jam e bindur se ai do të vazhdojë të punojë drejt forcimit të lidhjeve ndërmjet Kosovës dhe

Zvicrës, një aleat i vjetër dhe shtëpia e shumë qytetarëve në diasporë", ka shkruar Osmani. Deri tani në këtë pozitë ka qenë Sami Ukelli.



# Rreth 100 punëtorë të lënduar këtë vit, sigurimi shëndetësor në sirtar



**PRISHTINË, 2 MAJ** - Përveç dhimbjeve dhe pamundësise për të lëvizur, Rexhep Gashi brengosej edhe përmblimin financiar të trajtimit të tij.

I shtrirë prej ditësh në Klinikën e Ortopedisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, 52-vjecari ka këmbën e thyer dhe disa rruaza të shtylli kurrizore të krisura.

Ai u rrëzua derisa punonë në një skelë ndërtimi. "Nuk e di se çfarë më ka ndodhur në atë moment. Isha shumë i lodhur. Mendoj se përmblakat e lodhjes edhe jam rrëzuar", thotë Rexhepi përm "Radion Evropa e Lirë".

Shërbimet që mund t'ia ofrojnë QKUK-ja i merr falas, ndërsa të tjerat duhet t'i mbulojë vetë. Kështu, ai pagoi një jelek përmblakat kurri, të cilin ia rekomanduan mjekët. "Gjithçka është bërë e shtrenjtë... do të ishte mirë po të kishim sigurim shëndetësor nga shteti", flet Rexhepi, pa dashur të jepë më shumë hollësi rreth pagesës që ka bërë.

Sikurse ai, pa sigurim shëndetësor janë të gjithë qytetarët e Kosovës, përvrëc atyre që janë të siguruar përmes kompanive private që ofrojnë sigurime të tilla.

Ka 17 vjet që është miratuar një ligj përmblakat e sigurime shëndetësore, por çështja është zvarritur vazhdimi.

Zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë thonë se një projektligji i ri tanë "i ka kaluar fazat e konsultimeve publike" dhe se "grupi punues është në proces të inkorporimit të komenteve".

Se kur do të mund të përfitojnë qytetarët prej tij, nuk është ende e qartë.

## Nevoja përmblakat e sigurime shëndetësore

Në fillim të kësaj javë, kur REL-i ishte në QKUK, takoi edhe Hajriz Jonuzin, i lënduar, po ashtu, në vend të punës. Ai po e merrte vete pas një operacioni të gjatë që kishte pasur përmblakat e shakut të disa thyerjeve në trup. "E kam lidhur materialin në vinç dhe kur ai ka nisur të shkojë lart - unë nuk e kam shikuar më - është këputur dhe më ka rënë sipër", tregon Hajrizi momentin kur është lënduar.

Pa sigurim shëndetësor është edhe ai dhe thotë se ka shumë nevojë përmblakat.

Sipas Inspektoratit të Punës në Kosovë, deri më tash këtë vit, në vendet e punës janë lënduar 98 persona.

Vitin e kaluar, ky numër ishte 345 - prej tyre, 11 përfunduan me fatalitet.

Vesel Zhinopotoku, nga Inspektorati i Punës, thotë përm "Radion Evropa e Lirë" se numri më i madh i aksidenteve dhe vdekjeve në vendet e punës, regjistrohet në sektorin e ndërtimitarës.

Jusuf Azemi, kryetar i Sindicatës së Pavarur të Sektorit Privat, thotë se shifrat e të lënduarve në punë janë, më fakt, më të larta se ato zyrtare.

Sipas tij, ka punonjës që heshtin,

sepse punëdhënësit i joshin me kompensime financiare apo ngritje në pozitë. Ai thotë se Ligji përmblakat e sigurime shëndetësore në punë - në bazë të cilit punëdhënësi është i detyruar që t'i mbulojë të gjitha shpenzimet përmblakat e sigurime shëndetësore.

Kuvendi i Kosovës arriti ta miratonte Ligjin e ri përmblakat e sigurime shëndetësore në vitin 2014, mirëpo as ai nuk u zbatua.

Zbatimit të tij u tha se do t'i paraprinte një periudhë prej gjashë muajsh përmblakat e sigurime shëndetësore duke thënë se ka kosto të lartë", thotë Dreshaj.

2008, ishin vetë qeveritë e Kosovës ato që e tërhoqen ligjin, përmblakat e sigurime shëndetësore.

Kuvendi i Kosovës arriti ta miratonte Ligjin e ri përmblakat e sigurime shëndetësore në vitin 2014, mirëpo as ai nuk u zbatua.

Zbatimit të tij u tha se do t'i paraprinte një periudhë prej gjashë muajsh përmblakat e sigurime shëndetësore duke thënë se ka kosto të lartë", thotë Dreshaj.

Kryetarja Fatmire Kollçaku, nga Lëvizja Vetëvendosje në pushtet, shfaq besimin se projektligji do të arrijë përmblakat e sigurime shëndetësore... Pritjet janë të mëdha, por do të shkohet hapë pas hapi", thotë Kollçaku përm "Radion Evropa e Lirë".

Deputeti Shemsedin Dreshaj, anëtar i Komisionit përmblakat e sigurime shëndetësore...

"Sipas tij, as qeveritë e kaluara, as e tanishmja nuk e kanë marrë seriozisht çështjen. "Ne jemi shteti i vetëm në rajon që nuk kemi sigurime të mirëfillta shëndetësore... Nuk ka gjë më të shtrenjtë se shëndeti, andaj nuk mund të arsyetohet mungesa e Ligjit përmblakat e sigurime shëndetësore duke thënë se ka kosto të lartë", thotë Dreshaj.

Mungesa e sigurimit shëndetësore nuk është e vëtmja sfidë që mundon punonjësit në Kosovë.

Sipas Inspektoratit të Punës, shumë prej tyre - sidomos në sektorin privat - ankohen edhe përmblakat e sigurime shëndetësore duke thënë se ka kosto të lartë", thotë Dreshaj.

## Aksidentet në vendin e punës

Gjatë dhjetë vjetëve në Kosovë kanë humbur jetën 147 punëtorë në vendet e tyre të punës, kurse janë lënduar 933 punëtorë. Shumica e këtyre rasteve kanë ndodhur në sektorin privat. Përfaqësues të Sindikatës së sektorit privat konsiderojnë se këto shifra duhet të janë alarm përmblakat e sigurime shëndetësore.

## Saga që s'merr fund

Kosova nuk ka sigurime shëndetësore, ndonëse në vitin 2007 u miratua ligji përmblakat e sigurime shëndetësore.

Shumica e këtyre rasteve kanë ndodhur në sektorin privat. Përfaqësues të Sindikatës së sektorit privat konsiderojnë se këto shifra duhet të janë alarm përmblakat e sigurime shëndetësore.

Pas pavarësisë së Kosovës në vitin

Prishtinë, 2 maj - Komisioni përmblakat e sigurime shëndetësore, ndonëse në vitin 2007 u miratua ligji përmblakat e sigurime shëndetësore.

Deputetja Mimoza Kusari, e

cila e ka filluar këtë nismë, tha se qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i kornizave të mirëfillta të veprimitarës, nxitja e inovacionit dhe investimit, në mënyrë që, siç tha ajo, të krijohen parametra e sigurisë përmblakat e sigurime shëndetësore.

shpërlarjes së parasë si dhe aktivitete të tjera të jashtëligjshme. Më pas, pas diskutimeve në lidhje me temën anëtarët e komisionit mbështetën dhe miratuan këtë pikë, përmblakat e sigurime shëndetësore.



## Komisioni përmblakat e sigurime shëndetësore miraton projektligjin që rregullon tregtimin e kripto-aseteve

Prishtinë, 2 maj - Komisioni përmblakat e sigurime shëndetësore, ndonëse në vitin 2007 u miratua ligji përmblakat e sigurime shëndetësore.

Deputetja Mimoza Kusari, e ka filluar këtë nismë, tha se qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i kornizave të mirëfillta të veprimitarës, nxitja e inovacionit dhe investimit, në mënyrë që, siç tha ajo, të krijohen parametra e sigurisë përmblakat e sigurime shëndetësore.

shpërlarjes së parasë si dhe aktivitete të tjera të jashtëligjshme. Më pas, pas diskutimeve në lidhje me temën anëtarët e komisionit mbështetën dhe miratuan këtë pikë, përmblakat e sigurime shëndetësore.

# Bardi i Bruklinit



Nga: Lisa ALLARDICE  
Përkthimi: Telegrafi.com

Ashtu si Çikagoja për Saul Bellowin ose Nju-Xhersi për Philip Rothin, shkrimitari amerikan Paul Auster [3 shkurt 1947 – 30 prill 2024] gjithmonë do të mbetet sinonim i Bruklinit. Ishte “i shenjti mbrojtës i Bruklinit letrar” – sipas artikullit të *New York Times*-it, botuar pas vdekjes së tij këtë javë. Shumë kohë përparrë se Bruklini të përflytej për novelistët e rind aspirantë, Austeri e zuri vendin e vet me koleksionin e tij të parë, *Trilogjia e Nju-Jorkut* [*The New York Trilogy*] – veprën për të cilën do të mbahet mend më shumë. Cilido që lexon libra e që u rrit në vitet 1980, do ta ketë një kopje të dëmtuar diku në raftet e veta. *Qyteti i qelqit* [*City of Glass*], rrëfimi kryesor, u refuzua 17 herë përparrë se të botohej si roman në vitin 1985.

Mesatarisht botonte një libër në vit. Romani i tij i fundit, *Bamgartneri* [*Baumgartner*] – që flet për një autor tetëdhjetëvjeçar – u botua në fund të vitit të kaluar. Shkroi gjithashtu tekstin e librit me fotografi, *Gjakderdhja e kombit* [*Bloodbath Nation*] – për të shtënat masive në ShBA – i cili u botua në fillim të vitit të kaluar. Ishte sa i zhđërvjellët aq edhe i jashtëzakonshëm – në gjendje të përdorte me po aq elegancë dorën si ndaj teksteve letrare, ashtu edhe në përkthim, poezi

dhe skenarë. Siç thotë shkrimitarja amerikane Rachel Kushner, “që nga përkthimi i Maurice Blanchotit në fillimet e karrierës, te formësimi letrar në *Trilogjinë e Nju Jorkut* – të cilin çdo shkrimitar i brezit tim e lexoit, e përvetësoi dhe në një mënyrë reflektori – e deri në vitet e vona me biografinë prej 800 faqeve për Stephen Cranein, Austeri na tregon se çfarë do të thotë të jesh pafundësish kureshtar, ambicioz dhe mbi të gjitha letrar”.

Kujtimet e Austerit përfshijnë veprat *Shpikja e vëtmisë* (1982), që është një meditim mbi atësinë – shkruar pas vdekjes së babait; *Pasiguria* [*Hand to Mouth*, 1997], që flet për të rininë e varfër dhe jetën pa para si shkrimitar; dhe *Ditari i dimrit* [*Winter Journal*, 2012] që flet rreth plakjes dhe thyerjes shpirtërore. Në vitet 1990 shkroi edhe tre skenarë: *Tymi* [*Smoke*], *Fityra e trishtuar* [*Blue in the Face*] dhe *Lulu në urë* [*Lulu on the Bridge*], regjinë e të cilëve po ashtu e bëri.

Por, si shkrimitar i tregimeve të shkurtra dhe si romancier, ai e fitoi reputacionin si një prej shkrimitarëve më inventivë amerikanë të gjeneratës së tij – me veprat e mirënjohura që përfshijnë këta tituj: *Pallati i Hënës* [*Moon Palace*, 1989], *Muzika e rastit* [*The Music of Chance*, 1990] dhe *Libri i iluzioneve* [*The Book of Illusions*, 2002]. I vlerësuar si “yll roku” në Francë, në vitin 1991

nga Qeveria franceze u shpall kalarës i Urdhrit të Arteve dhe Letërsisë. Në vendin e vet ishte pjesë e një elite letrare amerikane – me miq të ngushtë ku përfshihen Don DeLillo, Peter Carey dhe Salman Rushdie. “Ishte vjetvetja”, shkroi Orhan Pamuk me email, miku i tij që kur u takuan më 1991. “Kam shumë respekt dhe admirim për punën e tij”.

Gruaja e tij e parë ishte shkrimitarja e tregimeve të shkurtra, Lydia Davis, e dyta Siri Hustvedt – lexuesja dhe redaktorja e parë qëkur u martuan në vitin 1982. “Nuk mund të mendoj asnë rast të vetëm kur unë nuk e kam ndjekur këshillën e saj”, ka thënë ai për *Paris Review* më 2003. (Përmes lojës së fjalëve, narratori i romanit të tij të vitit 1992, ka inicialet P. A., ndërsa gruaja e tij quhet Iris – Siri, e shkruar mbrapsht.) “Askush nuk mund të thotë se nga vjen një libër, aq më pak ai që e shkruan”, ka thënë Peter Aaron te *Leviatani* [*Leviathan*]. “Librat lindin nga injoranca, dhe nëse vazhdojnë të jetojnë pasi të janë shkruar, kjo është vetëm për nivelin në të cilin nuk mund të kuptohen”.

Si shkrimitar i ri në fund të viteve 1970, pushoi në përpjekjen për të bërë “letërsi” – pasi e gjeti stilin e vet të paimitueshëm. “Gjithmonë kam dashur të shkruaj atë që përmua është e bukur, e vërtetë dhe e mirë”, shkroi ai te *Jeta në*

*fjalë* [*A Life in Words*, 2017], “por, gjithashtu jam i interesuar për shpkjen e mënyrave të reja për të rrëfyer. Doja të nxirja gjithçka jashtë”. Dhe, kjo është pikërisht ajo që bëri: e lidhi post-modernizmin e ndërlikuar evropian me të zymtën amerikane [noir], për të bërë diçka kreative dhe të re. Puna e tij kishte tensionin e një thrilleri (kritiku i revistës *The New Yorker*, James Wood, akuzoi se veprat e tij kanë “atmosferën e filmave B”). Nga vrapimet e shkurta e deri te maratona e romanit 4321, i cili i tregon katër versione të së njëjtës histori (për një djalë hebre që lindi, po si Austeri, më 1947 në Njuark), Austeri gjithmonë i mjegullonte skajet midis trillimit dhe realitetit.


Humbja, pikëllimi dhe identiteti, versionet e vërvetes (në shkallë të ndryshme të maskimit) që shfaq në letërsi, referencat për shkrimitarët amerikanë të shekullit XIX, fletoret shënimëve dhe bejsbolli (deri në moshën 17-vjeçare donte të ishte bejsbolist), ishin temat që ai i donte.

E shkruante “një paragraf”, duke e filluar gjithmonë çdo roman me dorë – preferonte fletoret me vijat katërkëndëshe (katrorë të vegjël). “Çdo libër fillon me fjalinë e parë dhe pastaj vazhdooj derisa të arrij tek e fundit. Gjithmonë me rend, një paragraf pas tjetrit”, tha ai për *Paris Review*. Kur ishte i kënaqur me paragrin, atë e

shtypte. Deri në 15 vitet e fundit – kur një asistent nisi t'i shtyp ato në kompjuter – këtë vetë e bënte me makinën e shkrimit *Olympia* të cilën e bleu nga një mik në koleg më 1974 (me piktorin Sam Messer për këtë ka shkruar në librin e tij të vittit 2002, *Rrëfimi përmakinen time të shkrimit/The Story of My Typewriter*). Aktin e shtypjes e quante “leximi me gishta”, duke redaktuar dhe rishikuar vazhdimisht teksta vazhdonte tutje.

“Kaq shumë gjëra të çuditshme kanë ndodhur në jetën time, këtë shumë ngjarje të papritura dhe të pamundura, saqë nuk jam më i sigurt nëse ende e di se çfarë është realiteti”, tha ai në vitin 2003. Në një udhëtim kur ishte 14 vjeç, një djalë pranë tij u godit nga rrufeja. Qëndrimi pranë djaloshit “i cili në thelb u vra nga perënditë, ndryshoi gjithë pikëpamjen time për botën”, tha ai për *The Guardian* në vitin e kaluar, në një nga intervistat e tij të fundit. Kjo gjithashtu ndikoi në mënyrën se si shkroi: e përdori ngjarjen si tregim të shkurtër edhe në 4321. E, kohët e fundit familja e tij u godit nga tragedia – pas vdekjes së mbesës dhe më vonë të djalit të tij.

Për Austerin shkrimi ishte akt besimi dhe akt të cilit vazhdoi t'i shërbente deri në fund. “E bën një pakt me veten, për ta thënë të vërtetën dhe më parë e pret krahun e djathë sesa e thyen atë premtim”. /Telegrafi/



# Lansohet programi 'Super Sportistët'



**PRISHTINË, 2 MAJ** - Para përfaqësuesve të federatave, klubeve sportistëve dhe medieve të shtë paraqitur programi për performancë të lartë sportive "Super Sportistët". Programi mbështet sportistët përgjatë karrierës së tyre aktive dhe të shtë i ndarë në tri fazë, ndërsa përsnim ka rezultatet e sportistëve në Lojërat Olimpike 2028 në Los Angeles, Lojërat Mesdhetare 2030 dhe Lojërat Olimpike 2032. "Super Sportistët" synon t'i identifikojë dhe të përzgjedhë top-talentët e Kosovës dhe të ndihmojë në zhvillimin e tyre përmes mbështetjes financiare dhe trajnimit të specializuar. Kjo përfshin sigurimin e resurseve të nevojshme për trajnimin e tyre dhe pjesëmarrjen në stërvitje profesionale, përkujdesjen dhe zhvillimin shëndetësor, furnizimin me pajisje profesionale dhe inovative për zhvillim maksimal të potencialit, mbikëqyrjen e progresit sportiv dhe mirëqenies së sportistit përgjatë karrierës së tyre.

Profesionale. Për ciklin Olimpik 2024-2028, buxheti i programit është 4 milionë euro, ndërsa për cilësinë e këtij programi janë angazhuar profesionistë të dëshmuar nga fusha e sportit. Në hapje të konferencës folën zëvendësministrja Daulina Osmani, presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi dhe medalistja Olimpike në Xhudo, Majlinda Kelmendi.

Zëvendësministrja Osmani tha se një program i tillë i ka munguar vendit tonë dhe shpeshherë investimi në sport ka qenë barrë për prindërit, sportistët, federatat dhe klubet, duke theksuar se tashmë po kthehet fokusi te topsportistët. Prezantimi i këtij programi e quajti ngjarje të rëndësishme për sportin presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, i cili offroi bashkëpunim në zbatimin e tij me të gjithë aktorët e përfshirë. Medalistja Olimpike në Xhudo,

Majlinda Kelmendi, foli përrugëtimin e saj dhe vështirësitet që ka pasur gjatë karrierës në xhudo, duke besuar se investimet që po bëhen në sport dhe këtë program do të ndikojnë që në të ardhmen të kemi sportistë dhe kampionë të mëdhenj.

Prezantimi i programit u bë nga kryemjeshtri Driton Kuka, kryesues i Komisionit për Performancë të Lartë Sportive, i cili tha se ky program në qendër ka sportistin/en. Bazuar në pjesëmarrjet në Lojërat Olimpike dhe potentialin e shfaqur në vitet e fundit në arenën ndërkombëtare, programi parasqeh përkrahjen e sportistëve nga sporti i xhudos, boksit, mundjes, taekwondos, atletikës, notit, skijimit dhe shenjëtarisë sportive. Megjithatë, nuk përjashtohet mundësia e përfshirjes në program të sportistëve nga sportet e tjera në programin e lojërave olimpike, të cilët shfaqin potencial përritje të rezultateve kulmore në garat ndërkombëtare.

## SHKURT

### Fillojnë përgatitjet për turnirin tradicional 'Demush Mavraj'

Kanë filluar përgatitjet rreth organizimit të turnirit tradicional në futboll të vogël "Demush Mavraj". Organizatorët kanë paraparë që turniri të mbahet më 15 maj në Qendrën Sportive "IBOS", derisa ka filluar edhe paraqitja e ekipeve. Më 14 maj do të tërhiqet shorti në orën 21:00. Sipas organizatorëve, turniri pritet të jetë mjft madhështor dhe do të ketë shpërblime me medalje, Kupë dhe të holla. Ndërsa sistemi i lojës do të jetë 4+1. Dëshmorë Demush Mavraj ka rënë heroikisht para 25 vitesh. Demushi ishte arsimtar i Edukatës Fizike dhe kontributi në edukimin e brezave të rinjtë në kohë okupimi ka qenë i madh, siç ka qenë edhe kontributi në luftën çlirimtare.

### Mitrovica dhe Kosova VR, në finale të Kupës së Kosovës

Futbollistet e Mitrovicës dhe ato të Kosovës VR do të përballen në finalen e Kupës së Kosovës, pas fitoreve në ndeshjet e sotme gjysmëfinale. Mitrovica shënoi fitore të lehtë përballë Prishtinës me rezultat 11:0. Ndërkohë, Kosova VR kaloi në finale pas fitores së realizuar ndaj Malishevës me rezultat 1:0, pas vazhdimeve. Golin e fitores për prishtinaset e shënoi Alba Shabani. Ndesha finale do të zhvillohet më 23 maj në Kampin Nacional në Hajvali. Ndesjet gjysmëfinale të Kupës së Kosovës: Mitrovica - Prishtina (11:0), Kosova VR - Malisheva (0:0)-(1:0) pas vazhdimeve.

### KB Peja barazon serinë gjysmëfinale, finalisti vendoset të shtunën

Në një superndeshje dhe dramatike, Peja fitoi ndaj Golden Eagle Ylli 80:81 (26:20, 21:26, 15:13, 18:22), duke barazuar serinë gjysmëfinale të "play-off"-it në 2:2. Te Golden Eagle Ylli më i miri ishte Alonzo Verge Jr me 32 pikë, dhjetë kërcime e 12 asistime, kurse te Peja më i miri ishte Justin Davis me 22 pikë e 11 kërcime. Ndesha e radhës do të zhvillohet në Pejë, ku do të vendoset se kush do të kalojë në finale. Në finale tashmë është kualifikuar Trepça, që eliminoi Sigal Prishtinën 3:0 në gjysmëfinale.

### Muriqi në verë pritet të rikthehet në Turqi

Vedat Muriqi pritet të rikthehet në futbollin turk gjatë kësaj vere. Kështu raporton gazeta turke "Aksam", e cila thotë se Muriqi është shumë afër ta veshë sërisht fanellën e Fenerbahçes. Ky medium raporton se ylli i Kosovës e ka dëshirën për t'u rikthyer në Turqi te Fenerbahçe nëse palët bien dakord. Te skuadra turke, Muriqin e shohin si zëvendësues ideal të sulmuesit Edin Dzeko, i cili mund të largohet në fund të sezonit drejt Arabisë Saudite. Aktualisht vlera e Vedat Muriqit në treg është 15 milionë euro. Ai u largua nga Fenerbahçe në verën e vitit 2020, me Lazio që pagoi 21 milionë euro për yllin prizrenas. Sulmuesi 30-vjeçar, i cili ka luajtur në 83 ndeshje me fanellën e Mallorcës për dy sezone, ka kontribuar deri tanë me 27 gola dhe 9 asistime.

## Shtatë klube licencoohen për garat evropiane, KF Dukagjini jo

**PRISHTINË, 2 MAJ** - Komisioni i Shkallës së Parë për Licencimin e klubeve përgatit e UEFA-s ka marrë vendime në lidhje me procesin licencues për

edicionin 2024/25 të garave të UEFA-s. Përgatit përgatit e licencimit, shtatë prej tyre janë licencuar, kurse një nuk është licencuar. Klubet e licencuara janë: FC Ballkani, FC Drita, FC Llapia,

Nga tetë klube sa e kanë nisur procesin e licencimit, shtatë prej tyre janë licencuar, kurse një nuk është licencuar. Klubet e licencuara janë: FC Ballkani, FC Drita, FC Llapia,

FC Malisheva, FC Prishtina, SC Gjilani, KFF Mitrovica. Klubi i vetëm që nuk ka marrë licencën përgatit e UEFA-s për edicionin 2024/25 është KF Dukagjini.



## Marigona Hajdari vazhdon kontratën me Silkeborg-Voel

**PRIŠTINË, 2 MAJ** - Marigona Hajdari do të vazhdojë të luajë në Superligën e Danimarkës, njëren prej ligave më cilësore në botë. Një prej hendballisteve më të rendësishme të Kombëtares së Kosovës ka vazhduar kontratën

me skuadrën Silkeborg-Voel. Kësaj skuadre Marigona iu bashkua verën e kaluar, ndërsa në edicionin e ardhshëm garues synon të stabilizohet plotësisht dhe të jetë prej bartëseve kryesore të lojës. Edhe këtë edicion Marigona ka

pasur shumë paraqitje të mira. "Më duhet siguri dhe raport i mirë, kështu që më është dashur pak kohë që të përfshihem në ekip. Mendoj se isha në gjendje të kontribuojë dhe besoj se mund të ofrojë edhe më shumë. Kam pasur

edicion fantastik me ekipin nacional të Kosovës dhe këtu te Silkeborg-Voel. Ekipi është shumë i ri, por jam e bindur se mund të shkojmë larg së bashku. Kështu që jam shumë e lumbur që kam vazhduar", ka thënë Hajdari.



## Historia e pabesueshme e 'heroit' që mposhti PSG-në, deri në moshën 30-vjeçare ishte në kategorinë e dytë

**DORTMUND, 2 MAJ** - Niclas Fullkrug shënoi golin e vetëm për fitoren e Borussia Dortmundit kundër Paris Saint Germainit të mëkurën mbrëma në gjysmëfinalen e parë Ligës së Kampionëve dhe ky sulmues gjerman ka një rrugëtim vërtet interesant futbollit pas tij. Edhe pse tashmë është 32-vjeçar, vetëm tani ka dalë në skenën e madhe dhe po luan futbollin më të mirë në karrierën e tij. Deri në moshën 30-vjeçare ai ishte kryesisht sulmues i kategorisë së dytë, më pas paraqitjet e tij të shkëlqyera në Werder Bremen i dhanë një thirrje në kombëtaren gjermane, ku tani është sulmues i parë. Fullkrug përfitoi nga një asistim i mrekullueshëm nga Nice Schlotterbeck për t'i dhënë Dortmundit një epërsi të ngushtë në gjysmëfinalen e Ligës së Kampionëve kundër PSG-së. Pas ndeshjes së dytë, ai gol mund të jetë më i rëndësishmi i sezont për "Milionerët" dhe t'i çojë në mënyrë sensacionale në finalen e Ligës së Kampionëve, gjë që as tifozët më optimistë të klubit nuk e kishin shpresuar këtë sezoni. Por, rruga e Fullkrug ishte vërtet e vështirë. Ai e filloj karrierën e tij në Werder Bremen



dhe ishte pas një sezoni të mrekullueshëm në Bundesliga 2 që tërroqi vëmendjen e shumë skuadrave evropiane. Ai qëndroi edhe një sezon te Werderi dhe më pas u transferua te Dortmundi, ku edhe këtë vit po bën paraqitje të shkëlqyeshme. Silojtar i kategorisë së dytë, ai filloi të merrte thirrje në kombëtaren gjermane, ku shënoi 11 gola në 15 ndeshje dhe kështu cimentoi vendin e tij në Kampionatin Evropian. Ndërsa luftonte përmes t'u vendosur në një gradë më të lartë, Fullkrug u përball me vështirësi të shumta. Ka një histori interesante nga një seancë stërvitore në Werder. Përkatësisht, Fullkrug përfundoi në spital pas një

aksidenti gjatë stërvitjes dhe shkak ishte përplasja me një shokun e skuadrës gjatë së cilës shokut të skuadrës i ngeci dhëmbi në ballë. Përplasja aksidentale kokë më kokë ishte aq e rëndë saqë të dy duhej të shkonin në spital dhe mjekëve iu desh të nxirrin një dhëmb nga balli i Fullkrug. "Ishte shumë e rezikshme përmua për shkak të kërcënimit të infeksionit të shkaktuar nga bakterë", kujton Fullkrug për incidentin. Interesant është edhe pseudonimi që mban Fullkrug. Përkatësisht, ai njihet si "Lücke", që në gjermanisht do të thotë "bosh" apo "boshillék", dhe këtë e ka marrë përshkak të hapësirave të dhëmbëve të përparmë.

## Bostoni fiton ndaj Miamiit dhe kalon në fazën tjetër

**BOSTON, 2 MAJ** - Janë zhvilluar dy ndeshje në kuadër të ligës NBA. Boston Celticsi ka siguruar fazën tjetër të garave në elitën e basketbollit amerikan, pasi mposhti Miami Heat në ndeshjen e pestë dhe me serinë 4:1 kaloi tutje. Celticsi fitoi 118:84, në një sfidë ku ishte dominues nga fillimi deri në fund, duke i fituar të gjithë cerekët e lojës. Katër basketbollistë u dalluan në fitoren e Bostonit. Me nga 25 pikë më efikasit ishin Jaylen Brown e Derrick White, derisa me 17 kontribut dha Sam Hauser e 16 të tjerë Jayson Tatum. Te Miami Heat nuk kryen punë 23 pikët e basketbollistik Bam Adebayo. Në gjysmëfinale të Konferencës së Lindjes, Celticsi pret fituesin e seri të Cleveland Cavaliers-



Orlando Magic që momentalisht është 3:2. I udhëhequr nga Luka Doncic, Dallas Mavericksi ka arritur fitore përballe Los Angeles Clippersit me rezultatin 123:93. Dallas ishte dominues nga fillimi deri në fund, duke mos lejuar

kundërshtarin për asnjë moment t'ia rrezikojë fitoren. E në këtë fitore, Doncic ishte i pandalshëm me double-double prej 35 pikëve e 10 asistimeve. Tash Mavericksi udhëheq në seri ndaj Clippersit 3:2.

## Fernandes: Për të ardhmen mendoj pas 'Euro 2024'

E ardhmja e Bruno Fernandes mbetet ende përmes t'u përcaktuar. Pas disa sezonesh te Manchester Unitedi, nuk përashtohet mundësia që mesfushori

portugez të largohet nga "Djatë e Kuq". "Për momentin nuk po mendoj përmes ardhmen. Natyrish nuk varet vetëm nga unë. Një lojtar mund të

dëshirojë të qëndrojë në ekipin e tij, por në të njëjtën kohë dikush dëshiron që ai të qëndrojë. Si fillim kemi FA Cup, më pas do të mendoj përmes 'Euro 2024'. Nëse

dëshironi të jem i sinqertë, nëse më duhet të mendoj largimin nga Premierë Ligë, do ta bëj vetëm pas Kampionatit Evropian. Tani asgjë nuk mund

ta largoj vëmendjen time nga FA Cup dhe 'Euro 2024', se asgjë nuk është më e rëndësishme momentalisht", është shprehur Fernandes.

## SHKURT

### Enrique: Në Paris do të jemi më të fortë

PSG-ja pësoi humbje të mëkurën në Gjermani nga Borussia Dortmundi (1-0). Në përfundim të ndeshjes, trajneri i skuadrës franceze, Luis Enrique, ka komentuar këtë akt të parë, duke thënë dëshironin një tjetër rezultat. Ai shprehu bindjen se në ndeshjen kthyese nuk kanë çka të humbasin dhe se do të janë më të fortë. "Është futboll. Shumë herë është i mrekullueshëm, ndërsa herë të tjera shkon kështu. Do të kishim preferuar të ishim në një situatë më të mirë padyshim, por ishte një ndeshje e ekilibruar. E dinim se nuk do të ishte e lehtë. Megjithatë, në Paris do të jemi gati dhe të fortë, plus që nuk do të kemi asgjë përmes humbur", ka thënë Enrique.

### Trajneri i Dortmundit: Mund të kishim shënuar më shumë gola

Borussia Dortmund triumfoi 1-0 në gjysmëfinalen e parë ndaj PSG-së, duke hedhur një hap të rëndësishëm drejt finales së madhe. Në lidhje me këtë përballje foli edhe trajneri i skuadrës gjermane, Edin Terzić, i cili në prononcimin e dhënë përmes "DAZN", ndërr të tjera, deklaroi: "Ishte një fitore e merituar, një paraqitje e mirë e ekipit. Ne mund të kishim shënuar më shumë gola, por edhe ata mund të kishin shënuar. Kjo është arsyja pse rezultati është në rregull nga këndvështrimi im". "Ne vravuam shumë, ky fakt është shumë i rëndësishëm në një ndeshje si kjo. Gjithçka që na duhet tani është një barazim në ndeshjen e dytë, por duhet të tregohemi dinjitozë në ndeshjen e kthimit dhe ta shfrytëzojmë këtë avantazh që kemi përmes shkuan në finale", u shpreh Terzić.

### Rangnick refuzon ofertën e Bayernit

Bayern Muncheni është refuzuar nga Ralf Rangnick, raporton të enjten shtypi austriak. I njëjti lajm është konfirmuar edhe nga Federata Austriake e Futbolit, e cila bën me dije se Rangnick dëshiron ta vazhdojë punën në krye të kombëtares së Austrisë. Kontrata e tij është deri në fund të Kupës së Botës me Austrinë. "Ralf qëndron! Kemi shumë plane përmes së bërë së bashku", publikoi njoftimin federata austriake në kanalet zyrtare.

### Arsenali e nxjerr në shitje Jesusin

Skuadra e Arsenalit është gati ta sakrifikojë Gabriel Jesus verën e ardhshme. Sipas raportimeve të medieve britanike, "The Gunners" është në pritje të ofertave përsulmuesin brazilian. Ndonëse ka kontratë deri në 2027-n me klubin londinez, 27-vjeçari nuk është në planet e trajnerit Mikel Arteta, përmes këtë arsyen Arsenali dëshiron ta shesë këtë verë në mënyrë që të përfitojë sa më shumë nga largimi i brazilianit. Kartoni i Gabriel Jesus momentalisht vlerësohet 70 milionë euro dhe "The Gunners" nuk ka ndërr mend ta lë sulmuesin të largohet përmes një shifër më të ulët.

**PRISHTINA**




Ndërmarrja Publike Lokale  
"Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë



Në bazë të dispozitave të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" SH.A. shpalë këtë:

**KONKURS I BRENDSHËM**



**Titulli i vendit të punës:** Drejtor i Departamentit të Administratës, një (1);  
**Numri i referencës:** 04;  
**Lartësia e pagës mujore:** 1,000€ (një mijë euro) BRUTO.

**Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të kryesore:**

- Menaxhon dhe është përgjegjës për Departamentin e Administratës, në përpilimin e planeve krijon politikat në mënyrë që Ndërmarrja të avancojë në përgatitjen e personelit, procedura administrative, logistikë, organizim dhe çështje të tjera që hyjnë në kuadër të detyrave të departamentit;
- Është përgjegjës për udhëheqjen e stafit në Departamentin e Administratës me të gjitha dokumentet e nevojshme;
- Vlerëson efektivitetin e punës së stafit administrativ;
- Merr pjesë në komisionet vlerësuese për punësimin e stafit civil të ndërmarrjes;
- Merr pjesë në mbledhjet e stafit menaxhues, ndihmon KE-në në caktimin e objektivave të Ndërmarrjes;
- Këshillon, koordinon dhe bashkëpunon me KE për Departamentin e Administratës;
- Përgatit planet afat-mesme dhe afatgjata për departamentin e Administratës;
- Koordinon punën me të gjitha departamentet në lidhje me kërkeshat dhe obligimet e nevojshme në Ndërmarrje;
- Sipas procedurave ligjore përgatit dokumentacionin e nevojshëm për shërbimet që ofron Departamenti i Administratës dëi i procedon në departamente tjera;
- Është përgjegjës në vlerësimin vjetor të stafit të vet;
- Merr masa disiplinore ndaj punëtorëve që kanë përfornancë të dobët në përbushjen e detyrave të punës;
- Përgatit raporte pune për Departamentin e Administratës në arritjen e objektivave;
- Në raste të rëndësishëm së lartë është i obliguar të ruaj konfidencialitetin që i kërkohet nga Kryeshef Ekzekutiv;
- Për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

**Kriteret dhe kualifikimet profesionale:**

- Shkollim universitar;
- Së paku 3 (tre) vite përvjohë pune;
- Kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathësi kompjuterike (Microsoft Office).

**Dokumentet që duhet të dorëzohen:**

**Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë online dokumentet si në vijim:**

- Aplikacionin për punësim (i cili gjendet në faqen zyrtare [prishtinaparking.net](http://prishtinaparking.net) në rubrikën "Konkursi")
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë për përvjohë e punës (Trusti pensional);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 6 muaj);
- Vërtetimin tativor;
- CV-në;
- Letër motivuese;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjofteve.

**Kontratë pune për periudhë të pacaktuar, pa periudhë provuese.**

**MËNYRA E APLIKIMIT:**

Aplikimi bëhet vetëm në mënyrë elektronike në e-mail [apliko@prishtinaparking.net](mailto:apliko@prishtinaparking.net), ku të gjitha dokumentet duhet të ngarkohen sipas kërkuesve të përcaktuara përmes këtij konkursi. Pas aplikimit të suksesshëm, aplikantët do të njohohen me e-mail konfirmues. Nëse aplikanti nuk pranon e-mail konfirmues pas aplikimit, i nejti udhëzohet të kontaktojë numrin kontaktues 038/224-228 apo përmes e-mail adresës [apliko@prishtinaparking.net](mailto:apliko@prishtinaparking.net). Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të shqyrtohen ndërsa aplikacionet e mangëta do të refuzohen.

**MËNYRA E VLERËSIMIT DHE KRITERET E POENTIMIT:**

Vlerësimi bëhet përmes testimit me shkrim dhe intervistimit, ku kalueshmëria është arritja e së paku 55 pikëve nga të gjitha fazat e konkursit publik. Testimi me shkrim vlerësohet deri në 70 pikë, intervistimi vlerësohet deri në 20 pikë dhe CV (jetëpërshkrimi) i kandidatit vlerësohet deri në 10 pikë.

**Kalendari i përafërt i përfundimit të procedurave të konkursit:**

Procedurat e konkursit parashihet të procedojnë si në vijim: testimi me shkrim - brenda 32 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit, intervistimi - brenda 42 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit dhe njoftimi final - brenda 47 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit. Këto afate vlefjnë nëse nuk ka ankesa.

**Konkursi është i hapur në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data 02.05.2024 deri më 16.05.2024, deri në ora 23:59.**

**PRISHTINA**



Ndërmarrja Publike Lokale  
"Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë



Na temelju odredba članka 8. Zakona br. 03/L-212 o radu i članak 4. Administrativnog uputstva (MFPT) br. 01/2024 za regulaciju tenderskih postupaka u javnom sektoru, lokalno javno poduzeće "Prishtina Parking" SH.A. najavi ovo:

**INTERNI NATJEÇAJ**

**Naziv radnog mesta:** Direktor Odjela za administraciju, jedan (1);  
**Poziv na broj:** 04;  
**Iznos mjesecne plaće:** 1.000 € (tisuću eura) BRUTO.

**Opis glavnih dužnosti i odgovornosti:**

- Upravlja i odgovoran je za Administrativni odjel, u izradi planova kreira politike kako bi Društvo moglo napredovati u pripremi osoblja, administrativnim postupcima, logistici, organizaciji i drugim pitanjima koja spadaju u djelokrug poslova Odjela;
- Odgovoran je za vođenje osoblja u Administrativnom odjelu sa svim potrebnim dokumentima;
- Ocenjuje učinkovitost rada administrativnog osoblja;
- Sudjeluje u ocjenjivačkim komisijama za zapošljavanje civilnog osoblja društva;
- Sudjeluje na sastancima rukovodećeg osoblja, pomaže EK u postavljanju ciljeva Poduzeća;
- Savjetuje, koordinira i surađuje s EK za Odjel uprave;
- Pripremi srednjoročne i dugoročne planove za administrativni odjel;
- Koordinira rad sa svim odjelima u vezi zahtjeva i obaveza potrebnih u Poduzeću;
- U skladu sa zakonskom procedurom priprema potrebnu dokumentaciju za usluge koje nudi Odjel uprave i obrađuje je u drugim odjelima;
- Odgovoran je za godišnje ocenjivanje svog osoblja;
- Poduzima stegovne mjere prema radnicima koji ne ispunjavaju radne zadatke;
- Priprema izvješća o radu Odjela za administraciju u ostvarivanju ciljeva.
- U slučajevima velike važnosti, dužan je čuvati povjerljivost koju zahtijeva glavni izvršni direktor,
- Za obavljanje poslova i odgovornosti odgovoran je Glavnem izvršnom direktoru.

**Kriteriji i stručne kvalifikacije:**

- Sveučilišno obrazovanje;
- Najmanje 3 (tri) godine radnog iskustva;
- Tečajevi i druga usavršavanja tijekom profesionalne karijere;
- Imati dobre komunikacijske i pregovaračke vještine;
- Dobre poznavanje stranih jezika u pisanom i govornom obliku;
- Poznavanje rada na računalu (Microsoft Office).

**Dokumenti koje je potrebno dostaviti:**

**Kandidat za ovu poziciju mora dostaviti sljedeće dokumente putem interneta:**

**Zahtjev za zapošljavanje (koji se nalazi na službenim stranicama prishtinaparking.net u rubrici "Natječaji")**

- Dokaz o stručnoj spremi (ovjerena kopija);
- Dokaz o radnom iskustvu (Pension Trust);
- Potvrda koja nije pod istragom (ne starija od 6 mjeseci);
- Porezna potvrda;
- CV;
- Motivacijsko pismo;
- Ekstrakt rodjena;
- Presliku osobne iskaznice.

**Ugovor o radu na neodređeno vrijeme, bez probnog rada.**

**NAČIN PRIMJENE:**

Prijava se vrše isključivo elektroničkim putem na e-mail [apliko@prishtinaparking.net](mailto:apliko@prishtinaparking.net), gdje je potrebno postaviti sve dokumente prema uvjetima definiranim ovim natječajem. Nakon uspješne prijave, kandidati će biti obaviješteni potvrđnom e-poštom. Ukoliko podnositelj zahtjeva nakon prijave ne dobije potvrđni e-mail, isti se upućuje da se javi na kontakt broj 038/224-228 ili putem e-mail adrese [apliko@prishtinaparking.net](mailto:apliko@prishtinaparking.net). Prijava podnesene nakon roka neće se razmatrati, a nepotpune prijave odbacit će se.

**NAČIN OCIJENIJIVANJA I KRITERII BODOVANJA:**

Ocjenvivanje se provodi putem pisanih testa i intervjuja, pri čemu se prolaznim smatra ostvarenje najmanje 55 bodova iz svih faza javnog natječaja. Pismeni dio ispita ocenjuje se do 70 bodova, intervju se ocenjuje do 20 bodova, a životopis kandidata do 10 bodova.

**Okvirni rokovi za završetak natječajnih postupaka:**

Predviđeno je da se natječajne procedure odvijaju na sljedeći način: pismeni test - u roku od 32 dana od dana objave natječaja, razgovor - u roku od 42 dana od dana objave natječaja i konačna obavijest - u roku od 47 dana od dana objave natječaja. Natjecanja. Ovi rokovi vrijede ako nema pritužbi.

**Natječaj je otvoren u trajanju od 15 (petnaest) dana od 02.05.2024 do 16.05.2024 do 23:59 sati.**

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "ERUN" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811884718 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "ERUN" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811884718 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "ERUN" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811884718 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## NJOFTIM

Njotojmë të gjithe klientët se "Pro Edit", Sh.P.K., nga Prishtina me pronar Albulena Arifi ka marre vendim te shuaje biznesin me NUI: 811368605 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedures se Likuidimit. Njoftohen te gjithe klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë me kete kompani që te paragiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes ne gazete.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Pro Edit", d.o.o., od Prishtine sa vlasnikom Albulena Arifi donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 811368605 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavijivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all clients that "Pro Edit", L.L.C, has taken the decision to quit its business with NUI: 811368605, from Prishtina, with owner Albulena Arifi the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor - debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Nenin 7, paragrafi 8 të LIGJI NR. 08/L-145 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E INTEGRUAR TË NDOTJES, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e njofton operatorin IMN "Bau Block"Sh.p.k modifikim i LMI-së Jahoc, Gjakovë, shfrytëzimi i argjilës për prodhimin e blokave dhe produkteve tjera në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

### Për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar

Njoftohet publiku i interesuar se më datë: 23.05.2024, në ora 12:00, në hapësirat e Zyreve të administratës, do të organizohet debat publik nga operatori: IMN "Bau Block"Sh.p.k modifikim i LMI-së Jahoc, Gjakovë, shfrytëzimi i argjilës për prodhimin e blokave dhe produkteve tjera, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debatë publik do të organizohet për Aplikacionin për dhënien e Lejes Mjedisore të Integruar.

"IMN Bau Block" Sh.p.k

Gjakovë, dt. 02/05/2024



Në pajtim me Nenin 45.4 lidhur me Nenin 114 të Ligjit Nr. 06/L – 016 "Për Shoqëritë Tregtare" në Kosovë dhe duke pasur parasysh Vendimin e datës 30.04.2024 për Shpërbërje Vullnetare" të Shoqërisë Tregtare "PEE GROUP" SH.P.K. me numër unik të identifikimit NUI: 8112768078 me seli në Prishtinë,

Sot me datë 02.05.2024, shpallë këtë:

## NJOFTIM PËR SHPËRBËRJE VULLNETARE

- I. Shoqëria Tregtare "PEE GROUP" SH.P.K. ("Shoqëria") e regjistruar në ARBK me numër unik të identifikimit NUI: 811276808 me seli të regjistruar në Rr. 28 Nëntori BB1/10, HY-2, Nr. 5, 10.000 Prishtinë – Republika e Kosovës, ka vendosur të mbyllë / përfundoj aktivitetin e saj tregtar dhe të shpërndaj asetat (nëse ka) dhe të s'registrohet nga regjistri tregtar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës ("ARBK").
- II. Vendimi i Shoqërisë për Shpërbërje Vullnetare është nxjerrë nga personi kompetent / zyrtar, respektivisht nga aksionarja e vetme e Shoqërisë me datën 30.04.2024.
- III. Ftohen të gjithë Kreditorët eventual që kërkesat e tyre eventuale të pa-shtyera t'i dorëzojnë brenda afatit kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike nga data e publikimit të këtij Njoftimi.
- IV. Kërkesat e Kreditorëve eventual duhet të dorëzohen shoqërinë Tregtare "BD CONSULTANCY" L.L.C. me seli në Rr. Agim Ramadani A1/54, 10.000 Prishtinë – Republika e Kosovës, çdo ditë pune duke filluar nga ora 09:00 deri në orën 17:00, me person kontaktues znj. Tringa Bakalli.
- V. Kërkesat e dorëzura pas afatit të paraparë si në pikën e mësipërmë 4 (katër) të këtij Njoftimi apo Kërkesat e Kompletuara, nuk do të merren parasysh respektivisht nuk do të shqyrtohen.

\*\*\*\*\*

Prishtinë: 02-05-2024

e autorizuara e Shoqërisë:



**MEKA**  
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA  
1992



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

[facebook](https://www.facebook.com/gjejpuneshpjete) [www.facebook.com/gjejpuneshpjete](https://www.facebook.com/gjejpuneshpjete)

**RESTAURANT**

---

**SWISS**

**TAVERNA**

---

Tel: +377 45 400 156      +386 49 848 553

PRISHTINË

- >> SHPALLJE TË VOGLA <<**
- Kastriot Haxhiu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme sh.m.e. "Kadri Kusari".
  - Dafina Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore 1-9 "4 Dëshmorët".
  - Faton Pruthi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.Teknike "Nexhmedin Nixha".
  - Shqipe Gjocaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e vtit të I të sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi".
  - Rexhep Ondozi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha".
  - Zenat Sadiki shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.
  - Melhit Sadiki shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.
  - Artan Elshani shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.
  - Isamir Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.
  - Lirim Gashi shpall te pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.
  - Dita Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e Kolegjit "Mehmet Akif" në Prishtinë, 2018-2021.
  - Nexhmedin Tulla shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
  - Lavdije Sopi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Zef Lush Marku" Velezhe.
  - Zylmi Krasniqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën Q.K . "11 Marsi" Prizren.
  - Edita Beqa nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
  - Xhavit Januzi nga Nivokazi KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. Bujqësi "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
  - Fisnik Nixha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë, Elektroteknik.
  - Kingj Nikolla nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. " Kadri Kusari" Gjakovë.
  - Lëshoj lokalini më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
  - Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afér "Bill Clintonit", katër tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

